

Relacion Teknik

Objekti:

**PUNIME RIPARIMI
NE KATIN PERDHE DHE TE PARE
NE PALLATIN E KULTURES "NDUE SHYTI", PUKE**

PREGATITUR NGA:

DEA-N CONSULTING STUDIO
ING. LAVDRIM BRUKA

2025

Të përgjithshme.

Në qytetin e Pukës ndodhet Pallati i Kulturës “Ndue Shyti”, ku në katin e parë të saj ka një ambjent salle “leksionesh”. Nga statistika ndër vite ka një frekuentim të rregullt nëpërmjet aktiviteteve të ndryshmi që mbahen dhe organizohen nga Bashkia, apo rrethi i intelektualëve dhe grupeve shoqërore të ndryshme, si konferenca, takime, prezantime artistike, shkencore, etj. Salla e “leksioneve” lidhet me hollin i cili është një ambjent i konsiderueshëm e cila shërben për prezantimin paraprak të aktiviteteve nëpërmjet ekspozitave dhe stendave të vendosura rreth e qark saj. Kjo pjesë e pallatit të kulturës me hyrje në drejtim të jugut, përballë sheshit kryesor të qytetit ka frekuentim të shpeshtë, nëpërmjet kështre dy holleve lidhet edhe kati i dytë në të cilin ndodhet biblioteka.

Gjendja aktuale.

Nëpërmjet hollit dhe sallës së leksioneve ndodhet një korridor i ngushtë me gjerësi 1.53m dhe gjatësi 11m, i cili nuk ka ndonjë funksion përveç ndarjes së 3 ambjenteve të vogla (pa ndonjë funksion të veçantë). Në fund të korridorit (në katin e parë) ndodhet holli i cili ka rëndësi si vend qëndrim i përkohshëm për njerëzit përpara përgatitjes së takimit në orarin e përcaktuar nga axhentat e aktiviteteve. Holli duke qenë një vend qëndrim me fluks të madh të grupeve të njerëzve është i pamjaftueshëm me përmasën dhe hapsirën që ka. Rifiniturat e hollit si, suvatë, pllakat, et., si dhe rrjeti i ndricimit kanë nevojë për përmirësim, pasi kanë kaluar kohën e amortizimit. Edhe shkallët lidhëse ndërmjet kateve duhet të rikonstruktohen duke rivenë bazamakët e shkallëve me mermer dhe parapetin e anësor të shkallës. Përveç kësaj të parë është e nevojshme që të riparohet edhe holli i kësaj përdhe si vazhdim lidhës për sallën e leksioneve në katin e parë.

Masat inxhinierike.

Duke parë nga afër gjendjen e amortizuar të rifiniturave dhe domosdoshmërinë e ndryshimit të tipologjisë së kësaj të parë, duhet të realizohen këto punime:

1. Në katin përdhe :

- Punime riparimi të suvatimeve (mure dhe në tavan)
- Dyshemeja me pllaka mermeri ekzistuese do të zmerilohet duke i pastruar për t’ju rikthyer shkëlqimin e mëparshëm (nuk është e nevojshme zëvendësimi i tyre)
- Në preventiv për këtë kat (përdhe) nuk është parashikuar shtesë për instalimet elektrike, por gjatë zbatimit të punimeve mund të rishihet mundësia e saj duke përdorur fondin rezervë të planifikuar në preventiv, nëse është e nevojshme.

2. Në katin e parë:

- Prishje e mureve të tullës në hapsirën e brendshme të hollit që ndajnë korridorin e ngushtë me tre

ambjentet e vogla. (Prishja do të realizohet pasi të jetë siguruar qëndrueshmëria e soletës së katit të dytë në mbështetje, e cila do të konstatohet nga inspektimi i hollësishëm i mureve ndarëse dhe soletës mbi to).

- Në qendër do të ruhet një kollonë nga mos prishja e një pjese të murit ekzistues, ajo do të ketë përmasat me seksion (50x100)cm. Kjo kollonë pas riparimit me llac cemento do të vishet me alukoband.
- Punime riparimi të suvatimeve (mure dhe në tavan).
- Prishja e shtresës ekzistuese të pllaka dhe rivendosja e shtresës së re të tyre sipas parashikimit në preventiv.
- Në qendër të hapsirës së zgjeruar nga prishja e mureve ndarëse do të instalohet një reception me strukturë hekuri dhe vetratë d/alumini palsike.
- Instalimi i ndricimit dhe i prizave sipas planimetrisë apo nevojës së riformatimit që mund të dalë gjatë zbatimit të punimeve.

Krahas punimeve të hollit në kete kat janë parashikuar edhe punime në sallën e leksioneve, si : shtresa me pllaka, punime suvatimi në mure dhe tavane, patimin e mureve, etj.

Holli në anën e djathtë të saj lidhet me një ambient të vogël, i cili duhet të riparohet pasi është demtuar prej lageshtires e cila pikon nga tarraca e amortizuar, për këtë ambient duhet të riparohen suvate, të zevendesohet shtresa me pllaka, të rindertohet hidroizolimi i tarraces.




Fig.1 Planimetria e katit perdhe




Fig.2 Planimetria e katit te pare

Nr.	Kodi	Emërtimi	Njësia	Sasia	AMB. 1	AMB. 2	AMB. 3	AMB. 4
		1. Prishje						
1	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m3	14.0				
2	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	632.5				
3	2.426/12	Prishje suvatim solete (h<4m)	m2	296.8				
4	2.197/1	Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace)	m2	28.4				
		2. Punime Shtresash 2						
5	2.281	Heqje pllaka dysHEMEJE	m2	277.1				
6	2.267b	Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm	m2	234.5				
7	2.268a	Shkalle montazhi mermeri	m2	52.56				
		3. Punime dheu						
8	2.4	Transport mbeturinash, nga prishje te brendshme te godines, me krahe	m3	47.420				
		4. Instalime per Ndririm						
9	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	180				
10	2.487/a	F.V. Kuti suport pllaket 2 mod	copë	18				
11	2.485/d	F.V. Priza shuko universal	copë	14				
12	2.466	F.V. Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w	copë	24				
13	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	200				
14	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	210				
15	2.481/3	F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml	64				
16	2.485	F.V. Çelesa e priza 10 A me nulifikim	copë	11				
		5. Punime Tavani dhe Suvatimi						
17	2.3	Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah	m2	296.8				
18	2.31	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	632.5				
19	2.330/1	Patinim tavani me stuko	m2	306.8				
20	2.328/1	Patinim muri me stuko	m2	632.5				
21	2.324/2	Plintuse mermeri h = 10cm	ml	186.3				
22	2.298	Veshje fasade me alukobonde	m2	17.0				
		6. Punime Bojatisje						
23	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	939.3				
24	2.410/a	Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm	m2	15.48				
		7. Analiza teknike per punimet dhe instalimet teknologjike						
25	4.3	Konstruksione metalike te thjeshta	ton	0.5349				
		8. Punime Dyer Dritare						
26	2.373/1	F.V. Vetrare d/alumini plastike me dopio xham	m2	40.8				
27	2.383/1	F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e l-re.		10.815				
		9. Punime Hidroizolimi dhe Çatite						

28	2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B		44				
		10 Analiza jashte liste						
29	An1	Pastrim pllaka mermeri ne dyshemene e katit perdhe	m2	44.3				

Tab.1 Lista me zerat e punimeve qe do te aplikohen ne çdo ambjent.

Ne tabelen e mesiperme jane percaktuar punimet qe do te aplikohen sipas ambjenteve perkatese.

PUNOI:

ING. LAVDRIM BRUKA